

Tirane 07/04/2026

**KERKESE**  
**Per përjashtimin e gjyqtarit**

**DREJTUAR:** Kolegjit Civil te Gjykates se Larte

**PER DIENI:** Kryetarit te Gjykates se Larte, Z. Sokol Sadushi

**KERKUES:** Shoqëria “2A Group” (Degë e shoqërisë së huaj), me NUIS M12211048J, perfaqësues ligjor Valon Ademi, me adrese te Zyres Qendrore te Deges se Perfaqësimit ne Shqipëri: Rruga “Faik Konica”, pallati 6, shkalla 5, zyra 7 Tiranë 1010 perfaqësuar nga administratori Kushtrim Krivaqa me adrese elektronike e mail: [2agroupshpk.al@gmail.com](mailto:2agroupshpk.al@gmail.com) [aagroupks@gmail.com](mailto:aagroupks@gmail.com) dhe numer kontakti 0692064777.

**OBJEKTI:** Paraqesim kerkese per përjashtimin e gjyqtarit Artur Kalaja nga gjykimi i çështjes civile me objekt me objekt: *Rekurs kundër vendimit me numer 185 (39-2026-1569) date 19.02.2026 Gjykata e Apelit te Juridiksioni te Pergjithshem Tirane*

**BAZA LIGJORE:** Neni 42 i Kushtetutës, neni 6 KEDNJ, Nenet 4, 72/6, 74 e vijues të K.Pr.Civile.

**I NDERUAR GJYQTAR!**

Shoqëria “Vlora International Airport – VIA” SHPK, me NUIS M118090021, është një shoqëri tregtare e regjistruar në QKB më datë 17.05.2021, me objekt të veprimtarisë së saj zbatimin e Kontratës së Koncesionit të nënshkruar ndërmjet ortakëve të shoqërisë (Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues në procedurën e tenderit) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila, në mënyrë të veçantë, ndër të tjera, konsiston në projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).

Shoqëria VIA zotërohet aktualisht nga ortaku Shoqëria “MABCO Construction SA”, degë e shoqërisë së huaj me numër unik identifikimi të subjektit M21414035V, si dhe nga ortaku Shoqëria “2A Group”, degë e shoqërisë së huaj me numër unik identifikimi të subjektit M12211048J.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj tregtare është konstatuar se ortaku “MABCO Construction SA” ka kryer veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë

tregtare”, si dhe me Statutin e Shoqërisë VIA. Për këtë arsye, në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë VIA, të datës 15.12.2025, me rend dite “*Vlerësimin e veprimtarisë së ortakut ‘MABCO Construction SA’ etj.*”, është vendosur **autorizimi i Administratorit të VIA-s për t’iu drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për përjashtimin e ortakut “MABCO Construction SA”, si dhe për marrjen e masës së sigurimit të padisë.**

Në përputhje me këtë vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë VIA, nga ana e Administratorit të kësaj shoqërie është paraqitur kërkesëpadi me objekt:

1. *Përjashtimin e ortakut Shoqëria “MABCO Construction SA”, degë e shoqërisë së huaj e regjistruar me numër NUIS M21414035V, nga Shoqëria “Vlora International Airport – VIA” SHPK, me NUIS M118090021, me pasojë likuidimin e kuotës së tij në këtë shoqëri;*
2. *Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut Shoqëria “MABCO Construction SA” në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë “Vlora International Airport – VIA” SHPK, si dhe çdo të drejtë që rrjedh nga zotërimi i kuotës në këtë shoqëri, deri në marrjen e formës së prerë të vendimit përfundimtar.*

Në lidhje me kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 17959, datë 23.12.2025, ka vendosur pranimin e kësaj kërkeje, duke pezulluar të drejtën e votës dhe çdo të drejtë që rrjedh nga zotërimi i kuotës për ortakun “MABCO Construction SA”.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar “ankim të veçantë” Shoqëria “MABCO Construction SA”, ku, pas shqyrtimit të këtij ankimi në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 185 (39-2026-1569), datë 19.02.2026, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 17959, datë 23.12.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë jemi informuar se kundër këtij vendimi është paraqitur rekurs nga Shoqëria “MABCO Construction SA” dhe se dosja është përcjellë pranë Gjykatës së Lartë, ku, pas njoftimit të datës 04.05.2026 për datën e shqyrtimit të këtij rekursi në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, jemi vënë në dijeni të faktit se kjo çështje, në bazë të shortit, është caktuar për shqyrtim përpara gjyqtarit Artur Kalaja, në cilësinë e relatorit të saj.

Menjëherë pasi jemi vënë në dijeni të këtij fakti, si dhe brenda afatit ligjor të parashikuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, vlerësojmë të parashitshme kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit Artur Kalaja nga gjykimi i kësaj çështjeje.

Kjo kërkesë mbështetet në rrethanat konkrete për të cilat pala jonë ka marrë dijeni, të cilat lidhen me ekzistencën e njohjeve dhe marrëdhënieve të afërta profesionale dhe personale ndërmjet avokatit Ervin Metalla, përfaqësues i palës rekursuese Shoqëria "MABCO Construction SA", dhe relatorit të çështjes, që është pikërisht gjyqtari Artur Kalaja, ndaj të cilit po paraqitet kjo kërkesë për përjashtim. Në këtë kuptim, evidentojmë se avokati Ervin Metalla është avokati i vetëm i Shoqërisë "MABCO Construction SA" në këtë proces gjyqësor, i cili jo vetëm ka nënshkruar rekursin e paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, por gjithashtu ka depozituar edhe aktin e përfaqësimit në cilësinë e përfaqësuesit të vetëm ligjor të kësaj pale në gjykim. Për rrjedhojë, marrëdhëniet dhe afërsia e tij me relatorin e çështjes përbëjnë një rrethanë objektive dhe relevante, e cila, në vlerësimin tonë, është e tillë që krijon dyshime të arsyeshme lidhur me garantimin e standardit të paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykimit.

Me konkretisht shpjegojme se nga sa jemi vënë në dijeni, bazuar në fakte publike<sup>1</sup>, avokati Ervin Metalla ka ushtruar më parë funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Nga informacioni i siguruar prej nesh rezulton se pranë së njëjtës gjykatë ka ushtruar funksionin si gjyqtar edhe gjyqtari i Gjykatës së Lartë, z. Artur Kalaja, madje në të njëjtin trup gjykues me gjyqtarin Metalla, trup gjykues i cili ka funksionuar në këtë përbërje të paktën nga viti 2015 e në vijim (ku bashkalidhur po ju paraqesim disa vendime qe tregojne kete fakt), *çka evidenton qartazi ekzistencën e një marrëdhënieje të gjatë profesionale dhe, në mënyrë të pashmangshme, edhe njerëzore ndërmjet tyre.*

Gjithashtu, nga të dhëna të njohura publikisht rezulton se njohja dhe marrëdhënia e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Artur Kalaja, me ish-gjyqtarin Ervin Metalla, aktualisht përfaqësues i rekursuesit në këtë gjykim, daton që prej periudhës kur ata kanë qenë studentë në Shkollën e Magjistraturës, të emëruar në detyrë në vitin 2001. Ky fakt evidentohet qartë edhe nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të kësaj shkolle, të cilat po jua përcjellim bashkëlidhur me kërkesën për përjashtim.

Bazuar në këto rrethana, për shkak të njohjeve dhe marrëdhënieve të afërta që burojnë si nga periudha e studimeve, ashtu edhe nga marrëdhënia e mëparshme profesionale që gjyqtari Artur Kalaja ka pasur në mënyrë të ndërsjellë me përfaqësuesin e palës rekursuese, ish-gjyqtarin Ervin Metalla, ankues në rekursin që ndodhet për shqyrtim përpara jush, na krijohet një dyshim i arsyeshëm mbi mundësinë e ushtrimit të gjyqimit në mënyrë të paanshme dhe të pavarur në këtë çështje.

Për këtë arsye, vlerësojmë se duhet t'ju drejtohem me këtë kërkesë, duke kërkuar përjashtimin e gjyqtarit Artur Kalaj nga gjykimi i kësaj çështjeje.

---

<sup>1</sup> Neni 13 I K.Pr.Civile: Faktet e njohura botërisht ose zyrtarisht nuk ka nevojë të provohen. Faktet, për të cilat ekziston një prezumim ligjor, nuk duhet të provohen nga pala në dobi të së cilës është prezumimi.



Në **aspektin procedural**, shpjegojmë se nga ana jonë po paraqitet kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit në përputhje me parashikimet e nenit 74 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit:

*“ Në rastet kur është e detyrueshme heqja dorë e gjyqtarit, secila nga palët mund të kërkojë përjashtimin e tij.*

**Kërkesa e nënshkruar nga pala përkatëse ose nga përfaqësuesi i saj, duhet të depozitohet në sekretarinë e gjykatës kur është bërë i ditur emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve që shqyrtojnë çështjen dhe në rastin e kundërt menjëherë pas shpalljes së gjyqtarit apo gjyqtarëve që do të gjykojnë çështjen.**

Paraqitja e mëvonshme e kërkesës lejohet vetëm kur pala ka marrë dijeni më vonë për shkakun e përjashtimit ose kur gjatë ushtrimit të funksioneve, gjyqtari ka shfaqur mendim të njëanshëm e në mënyrë të papërshtatshme mbi faktet dhe rrethanat objekt gjykimi, por sidoqoftë jo më vonë se tri ditë nga marrja dijeni.

*Kërkesa duhet të përmbajë shkaqet e përjashtimit, dokumentet e provat e tjera që disponohen.”*

Në këtë kuptim, sqarojmë se pala jonë është vënë në dijeni të emrit të relatorit të çështjes vetëm pas njoftimit mbi datën e shqyrtimit të saj në dhomë këshillimi, njoftim i dërguar në adresën elektronike të shoqërisë më datë 04.05.2026. Pikërisht pas marrjes dijeni për përbërjen gjykuese dhe identifikimit të relatorit të çështjes, pala jonë ka kryer verifikimet përkatëse dhe është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë shkakun e kërimit për përjashtim. Për rrjedhojë, rezulton qartazi se kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit po paraqitet në përputhje të plotë me paragrafin e tretë të nenit 74 të Kodit të Procedurës Civile, brenda afatit ligjor 3-ditor nga momenti i marrjes dijeni mbi rrethanat që justifikojnë paraqitjen e saj.

**Ne aspektin material** shpjegojmë se ne nenin 72 të K.Pr.Civile parashikohet:

**Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur:**

1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim;
2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt ose krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërën nga palët ose nga mbrojtësit;
3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërën prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;
4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetres palë;
5. është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në gjykim;

**6. në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.**

Nderkohe ne nenin 73 te ketij kodi parashikohet: *“Në rastet kur është e detyrueshme heqja dorë e gjyqtarit, secila nga palët mund të kërkojë përjashtimin e tij.”*

Bazuar në këto shkaqe ligjore, shpjegojmë se, në paraqitjen e kësaj kërkesë nga ana jonë, vlerësohet se gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore, gjykata duhet të shmangë çdo veprim apo rrethanë që mund t'i krijojë palës perceptimin e mungesës së paanshmërisë në vendimmarrje. Në këtë drejtim, gjykata ka detyrimin të ruajë një qëndrim të barabartë ndaj të gjitha palëve ndërgjyqëse, jo vetëm në përmbajtjen e vendimmarrjes së saj, por edhe në mënyrën e komunikimit dhe sjelljes proceduriale ndaj tyre.

Gjykata, në ushtrimin e funksionit të saj kushtetues dhe ligjor, ka detyrimin jo vetëm të japë drejtësi, por edhe të garantojë dhe përcjellë besimin e palëve dhe të publikut në paanshmërinë, pavarësinë dhe integritetin e procesit gjyqësor. Pikërisht për këtë arsye, standardi i paanshmërisë së gjykatës nuk lidhet vetëm me ekzistencën e njëanshmërisë reale, por edhe me perceptimin objektiv që krijohet tek palët lidhur me mënyrën se si administrohet drejtësia.

Në vlerësimin e respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkohet përmbushja e disa standardeve themelore, të cilat përbëjnë elemente thelbësore të një procesi të drejtë gjyqësor, konkretisht:

1. Gjykimi i çështjes nga një gjykatë e krijuar me ligj;
2. Zhvillimi i gjykimit publikisht;
3. Zhvillimi i një procesi të drejtë dhe të ndershëm;
4. Shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e pavarur;
5. Gjykimi nga një gjykatë e paanshme dhe e pa paragjykuar;
6. Zhvillimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në këtë kuadër vlerësojmë se paanshmëria e gjykatës përbën një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, pasi çdo rrethanë që krijon dyshime objektive mbi këtë paanshmëri cenon besimin e palëve tek drejtësia dhe legjitimitetin e vetë procesit gjyqësor. Secili nga keto 6 standarte te se drejtes per nje proces te rregullt ligjor, ndervepron ne menyre dinamike me standartet e tjera. Pra cenimi i nje standarti, mund te sjelle edhe cenimin e standarteve te tjera.

Ndodhur në kushtet e një marrëdhënieje të tillë njohjeje dhe afriteti profesional e miqësor, ***të krijuar dhe konsoliduar përgjatë një periudhe të konsiderueshme kohore ndërmjet gjyqtarit Artur Kalaja dhe ish-gjyqtarit Ervin Metalla***, aktualisht përfaqësues i palës rekursuese, krijohet

objektivisht një dyshim i arsyeshëm mbi mundësinë që gjyqtari relator pranë Gjykatës së Lartë të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë plotësisht të paanshme dhe të pavarur.

Në këtë kuptim, pavarësisht ekzistencës ose jo të njëanshmërisë konkrete në shqyrtimin e çështjes, vetë ekzistenca e rrethanave të tilla, të cilat mund të krijojnë tek pala perceptimin e mungesës së paanshmërisë, mjafton për të cenuar besimin që palët duhet të kenë tek administrimi i drejtësisë dhe tek garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, në funksion të garantimit të standardit kushtetues dhe konvencional të një gjykimi të paanshëm, vlerësojmë se ekzistojnë shkaqe të mjaftueshme për pranimin e kësaj kërke për përjashtim.

Në vendimin me numër 47, datë 07.11.2011, Gjykata Kushtetuese e R.SH. për paanësinë e gjykatës mban këtë qëndrim: *Një nga elementët e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Gjykata merr parasysh, inter alia, veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk ofrojnë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010, të Gjykatës Kushtetuese)..... Edhe GJEDNJ-ja e ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e saj respektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Në çështjen Kyprianou kundër Qipros, datë 15 dhjetor 2005, §118, GJEDNJ-ja ka theksuar se “është shumë e rëndësishme në një shoqëri demokratike që gjykata të ngjallë besim tek publiku dhe tek i akuzuari”. Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që pretendojnë anshmërinë është i rëndësishëm por jo vendimtar. Vendimtare është nëse ky shqetësim mund të konsiderohet objektivisht i justifikuar (shih Ferrantelli and Santangelo, supra, § 58; Eettstein kundër Zvicrës, datë 21 dhjetor 2000, §44). .... Në vijim, duke pasur parasysh çka më sipër, Gjykata vlerëson se kur ekzistojnë kushtet që justifikojnë një dyshim të përligjur për anshmëri gjatë gjykimit, detyra e çdo gjyqtari është t'i shmanget gjykimit, në mënyrë që të mos cenohet rregullsinë e procesit gjyqësor për sa i përket aspektit të paanshmërisë së gjykatës.*

Po kështu dhe me vendimin me numër 2, datë 22.01.2014 Gjykata Kushtetuese për paanshmërinë e gjykatës shprehet: “Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe

neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjytimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njërës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet..... Gjykata, në jurisprudencë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit. Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim... Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor”

Ne lidhje me kriteret e vlerësueshme për përjashtimin e gjyqtarit nga jurisprudenca e GJEDNJ, ne çështjen, *Micallef v. Malta Ankimi nr. 17056/06 Vendim i Dhomës së Madhe (Grand Chamber)*, datë 15 tetor 2009 Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut arsyetoi se edhe perceptimi objektiv i mungesës së paanshmërisë është i mjaftueshëm për të cenuar standardin e gjykimit të drejtë sipas nenit 6 të Konventës. Konkretisht, gjyqtari që shqyrtonte çështjen kishte lidhje të afërta familjare me avokatët e njërës palë, dhe GJEDNJ vlerësoi se këto marrëdhënie ishin të tilla që krijojnë tek pala tjetër dyshime objektivisht të justifikuara mbi paanshmërinë e gjykatës. Gjykata theksoi se drejtësia jo vetëm duhet të administrohet në mënyrë të paanshme, por edhe të duket si e tillë në perceptimin e publikut dhe të palëve ndërgjyqëse. Sipas gjykates standardi i paanshmërisë nuk lidhet vetëm me ekzistencën e njëanshmërisë reale, por edhe me perceptimin objektiv që krijohet tek palët dhe publiku mbi mënyrën e administrimit të drejtësisë. Në këtë kuptim, edhe ekzistenca e marrëdhënieve të afërta ndërmjet gjyqtarit dhe përfaqësuesve të njërës palë është vlerësuar si rrethanë që mund të krijojë dyshime legjitime mbi paanshmërinë e gjykimit.”

Bazuar në keto standarte kushtetuese ka disa vendimi të Gjykates së Lartë me të cilat është pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtareve. Kështu Gjykata e Lartë, me vendimin *nr. 90002-00627-00-2025, datë 03.12.2025*, ka pranuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarëve ....., duke evidentuar rëndësinë që merr standardi objektiv i paanshmërisë dhe perceptimi i palëve mbi administrimin e drejtësisë. Kjo praktikë konfirmon se, për pranimin e kërkesës për përjashtim, nuk kërkohet domosdoshmërisht provimi i njëanshmërisë konkrete të gjyqtarit, por mjafton ekzistenca e rrethanave që krijojnë një dyshim objektivisht të arsyeshëm mbi paanshmërinë e tij.”

Nderkohe në vendimin me numër 00-2024-1020 date 03.06.2024 ne lidhje me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit Gjykata e Lartë arsyetoi se, *megjithëse formalisht nuk provohej ndonjë shkak*

*klasik papajtueshmërie apo njëanshmërie subjektive nga ana e gjyqtarit ....., vetë përmbajtja e mendimit të tij me shkrim tregonte se ai kishte krijuar një perceptim personal dhe emocional ndaj palës kërkuese, për shkak të ngjarjes së rëndë të vitit 2003, të cilën ai e kishte përjetuar drejtpërdrejt si gjyqtar. Gjykata vlerësoi se, edhe pse nuk ekzistonte një konflikt aktual apo njëanshmëri e provuar në kuptimin subjektiv, mënyra se si vetë gjyqtari ishte shprehur mbi personin e gjykuar krijonte objektivisht dyshime mbi paanshmërinë e tij. Për këtë arsye, u çmua se “qoftë dhe vetëm në dukje paanshmëria është cenuar”, duke e bërë të nevojshëm përjashtimin e tij për të garantuar besimin tek drejtësia dhe standardin e një procesi të rregullt ligjor.*


Bazuar në faktet e evidentuara më sipër, vlerësojmë se për shkak të marrëdhënieve të afërta profesionale dhe njerëzore, të krijuara dhe konsoliduara ndër vite ndërmjet gjyqtarit Artur Kalaja dhe ish-gjyqtarit Ervin Metalla, aktualisht përfaqësues i palës rekursuese në këtë gjykim, ekzistojnë rrethana objektive të cilat krijojnë tek pala jonë dyshime të arsyeshme mbi mundësinë e ushtrimit të gjykimit në mënyrë plotësisht të paanshme dhe të pavarur. Në këtë kuptim, theksojmë se standardi i paanshmërisë së gjyqtarit nuk lidhet vetëm me mungesën e njëanshmërisë reale apo subjektive, por edhe me perceptimin objektiv që krijohet tek palët ndërgjyqëse lidhur me mënyrën se si administrohet drejtësia. ***Pikërisht për këtë arsye, jurisprudenca kombëtare, por edhe ajo e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, kanë konsoliduar parimin sipas të cilit drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por edhe duhet të duket se jepet.***

Për rrjedhojë, në kushtet kur ndërmjet gjyqtarit relator Artur Kalaja dhe përfaqësuesit të palës rekursuese, ish-gjyqtarit Ervin Metalla, ekziston një marrëdhënie e posaçme dhe e zgjatur në kohë, e krijuar si nga periudha e studimeve në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe nga ushtrimi për një kohë të gjatë i funksioneve pranë së njëjtës gjykatë dhe në të njëjtat trupa gjykuese, vlerësojmë se në rastin konkret ***nuk tejkalohet testi objektiv i paanshmërisë***, pra standardi mbi bazën e të cilit një palë ndërgjyqëse duhet të krijojë bindjen legjitime se çështja e saj do të shqyrtohet nga një gjykatë plotësisht neutrale, e pavarur dhe e paanshme. Në këto kushte, pa paragjykuar integritetin profesional apo subjektiv të gjyqtarit Artur Kalaja, por në funksion të garantimit të besimit të palëve tek administrimi i drejtësisë, respektimit të standardeve të procesit të rregullt ligjor dhe shmangies së çdo perceptimi objektiv mbi mungesën e paanshmërisë, kërkojmë përjashtimin e gjyqtarit Artur Kalaja nga gjykimi i këtij rekursi.

Përsa me sipër, bazuar në nenin 72/6 të K.Pr.Civile

#### **KERKOJME:**

Përjashtimin e gjyqtarit Artur Kalaja nga gjykimi i çështjes civile me objekt: “Shqyrtimin e rekursit kundër vendimit nr. 185 (39-2026-1569), datë 19.02.2026, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.



**KERKUES**  
**SHOQERIA "2 A Group" SHPK**  
**ADMINISTRATORI**  
**Kushtrim Krivaqa**

KUSHTRIM KRIVAKA



***Bashkalidhur me kërkesën ju dërgojmë keto akte:***

1. *Listen e magjistrateve te diplomuar ne vitin 2001 ne Shkollen e Magjistratures.*
2. *Vendim me numër .....Gjykata e Apelit Tirane*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER XHOANA OMARI**

**DATE 07/05/2026  
NR REP 2401**



V2026053810095678513

**VËRTETIM NJËSIE ME ORIGINALIN**

Sot, më datë 07/05/2026, para meje Noteres XHOANA OMARI, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MINE PEZA, GODINA NR. 1, APARTAMENTI NR. 1, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**

Taulant Godroli, atësia Kristo, amësia Theodhora, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Vangjush Furxhi; Nd. 16; H. 2; Ap. 1; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 08/02/1988, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 040016060 dhe nr. personal I802080660, .

Vendim nr.555, date 02.03.2017

Unë Noterja, pasi i bëra të qartë personit të mësipërm, përgjegjësinë penale në rast paraqitje të dokumenti të rremë; bëra krahasimin e përmbajtjes së dokumentit origjinal me fotokopjen e paraqitur, mbi të cilat më rezultoi se nuk janë bërë korrigjime, shtesa, fshirje, a shenja të tjera të dyshimta.

Si rrjedhim, në bazë të nenit 62, shkronja “i”, nenit 129 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”; Vërtetoj se fotokopja e dokumentit të paraqitur nga kërkuesi para meje Noteres, është e njëjtë me dokumentin origjinal.

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19/12/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të kërkuesit të këtij dokumenti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**XHOANA OMARI**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT TIRANË**



Nr. 4741/2153 i Regj. them.  
Nr. 555 i Vendimit

Datë rregjistrimi 06.10.2015  
Datë vendimi 02.03.2017

**V E N D I M**

*"Në emër të Republikës"*

Gjykata e Apelit Tiranë e përbërë nga gjyqtarët:

**Ervin Metalla-Kryesues**  
**Maria Qirjazi-Anëtare**  
**Artur Kalaja-Anëtar**

asistuar nga sekretarja Entela Omeri, sot, me datë 02.03.2017, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile nr. 4741/2153 akti, që i përket:

**PADITËS:**

Zylfie Alla.  
Ermira Vorpsi.  
Ëngjëll Vorpsi.  
Arben Petrela.  
Myzejen Petrela.  
Aida Brari.  
Shpresa Petrela.  
Majlinda Zelka.  
Genci Petrela.  
Gilmond Petrela.  
Ali Petrela.  
Sabina Petrela.  
Altin Androja.  
Elisaveta Qyrama.  
Edmond Androja.  
Agim Petrela.  
Myslym Petrela

Afërdita Qordja.

Që të gjithë të përfaqësuar nga av. Maksim Gjokutaj.

**TË PADITUR :**

Alfred Ndreca.

Lulëzime Ndreca.

Që të dy të përfaqësuar nga av. Besim Gjikani.

Sefer Mena, në mungesë

**PËRSON I TRETË:**

Drejtoria e Aluiznit Tiranë, nr. 1, në mungesë.

**OBJEKTI:**

Detyrimin e të paditurve të kthejnë dhe dorëzojnë paditësive dhe bashkëpronarëve të tjerë Petrela sendin, pasuri e paluajtshme, i cili mbahet në mënyrë të paligjshme nga të paditurit.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 296 i Kodit Civil, si dhe nenet 32, 153 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 4316, datë 26.05.2015, ka vendosur ëzimin e kërkesëpadisë.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim pala paditëse, që ka kërkuar ndryshimin e tij dhe animin e padisë, duke parashtruar, ndër të tjera, se:

-Gjykata e shkallës së parë ka arritur në një përfundim të gabuar, pasi të paditurit janë në keqbesim, sa kohë e kanë okupuar pronën në mënyrë të kundraligjshme, fakt i cili rezultoi dhe nga vetëdeklarimet e tyre për legalizim, ku në rubrikën "lloji i pronës mbi të cilën është dërtuar" kanë vënë shënimin pa njohje pronësie, duke vërtetuar, në këtë mënyrë, se ata që në llim kanë pasur dijeni se ky truall ka qenë pronë e palës paditëse;

-Paditësit janë pronarë të ligjshëm dhe legjitimohen në ngritjen e padisë së rivendikimit objekt gjykimi, ndaj poseduesve jopronarë, të paditurve Alfred e Lulezime Ndreca, si dhe Sefer Mena;

-Sipas ligjit të legalizimeve, përjashtohen nga legalizimi objektet ku ka plane studimi të miratuar dhe aktualisht zona, jo vetëm që ka studim të miratuar, por ka filluar edhe zbatimin e këtij studimi. Kemi sqaruar se me VKM-në nr. 752, datë 05.09.2013, është vendosur shpronësimi një sipërfaqe prej 157 m<sup>2</sup> të këtij trualli prej 4500 m<sup>2</sup> në pronësi të paditësve, për ndërtimin e gjatimit të bulevardit të Tiranës dhe sipas pikës 8 të kësaj VKM-je, për momentin, veprimet me këto numra pasurie janë të pezulluara, ndaj nuk mund të marrim një vërtetim të rifreskuar të pronësie;

-Gjykata arsyeton në mënyrë të cekët, sipërfaqësore dhe të paprovuar, kur deklaroi në ndim se të paditurit kanë ndërtuar para se paditësit të njihen pronarë. Prona në pronësi të paditësve ka origjinë vendimin e ish KKKP Tiranë dhe është i viteve 2000 e më parë. Në dosje nuk ka asnjë akt që të vërtetojë që paditësit janë zhveshur nga pronësia mbi sendin dhe këtë pronësi e ka fituar i padituri Alfred Ndreca. VKM-ja nr. 1038, datë 14.11.2009, ka dalë para se bëhej miratimi i studimit për zgjatimin të bulevardit të Tiranës dhe rivitalizimin e Lumit të Tiranës, e për pasojë të dëlnin klauzola ndaluese për legalizim në këtë zonë.

Gjykata e Apelit Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen dhe dëgjoi relatimin e kryesuesit, palën paditëse, që kërkoi ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e padisë, i paditurit Alfred Ndreca e Lulëzime Ndreca, që kërkuan lënien në fuqi të këtij vendimi, si dhe anulloi gjykimin në mungesë të të paditurit Sefer Mena dhe personit të tretë Drejtoria e Aluiznit Tiranë, nr. 1,

## VËREN

Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi, në kuptim të nenit 466/ "a" të Kodit të Procedurës Civile. Ky vendim i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat përbëjnë edhe objektin e mosmarrëveshjes.

### I. Rrethanat e çështjes.

1. Nga gjykimi në gjykatën e shkallës së parë ka rezultuar e provuar se, referuar vërtetimit nga dokumentet hipotekorë të lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, me datë 18.11.2008, paditësit janë pronarë, ndër të tjera, edhe të pasurisë me nr. 6/52, Zona Kadastrale 8330, me sipërfaqe 4500 m<sup>2</sup>, regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 25, datë 08.01.2008, e cila ndodhet në lagjen "Brrakë" të qytetit të Tiranës.

2. Nga ana tjetër, i padituri Sefer Hasan Mena është posedues i një banese informale, shtëpi banimi një kat, të vetëdeklaruar për legalizim me datë 24.03.2005, e cila ka një sipërfaqe ndërtimore 66,0 m<sup>2</sup>, mbi një parcelë prej 245,7 m<sup>2</sup>.

3. Po kështu, edhe i padituri Alfred Kol Ndreca, bashkëshorti i të paditurës tjetër Lulëzime Ndreca, ka vetëdeklaruar për legalizim një banesë-shtëpi një kat, ngjitur me atë të paditurit Sefer Mena, e cila ka një sipërfaqe ndërtimore prej 83,7 m<sup>2</sup>, mbi një parcelë prej 303,6 m<sup>2</sup>.

4. Nga akti i ekspertimit të Ing. Irma Sula, marrë si provë gjatë gjykimit në shkallë të parë, ka rezultuar e provuar se ndërtimi informal i vetëdeklaruar për legalizim prej të paditurit Alfred Ndreca, me nr. 8/360, ZK 8330, si dhe ai me nr. 8/359, ZK 8330, ndodhen brenda pasurisë me nr. 6/52, në pronësi të palës paditëse.



5. Bazuar në sa më lart, pala paditëse ka kërkuar prej palës së paditur lirimin dhe orëzimin e sendit, truallit të zënë prej të paditurve, nëpërmjet ndërtimeve informale. Sipas palës paditëse, të paditurit janë në keqbesim, pasi që në fillim, kur e kanë zënë tokën dhe kanë dërtuar, e kanë ditur që prona në fjalë nuk është e tyre, por e palës paditëse.

6. Pala e paditur ka kërkuar rrëzimin e padisë, me argumentin se janë posedues të gjshëm, sa kohë ndërtimet e tyre janë legalizuar apo janë në proces legalizimi, ndërsa paditësit të dëmshpërblehen nga shteti.

7. Gjykata e shkallës së parë, pasi ka dëgjuar palët dhe administruar provat, ka aritur në përfundimin se padia nuk është e bazuar në prova e në ligj dhe, si e tillë, duhet rrëzuar. Pas kësaj gjykate, nuk provohet që pala e paditur ka qenë në keqbesim, pasi ato kanë kryer vetëdeklarimet për legalizim të ndërtimeve të tyre informale që në vitin 2005, ndërkohë që pala paditëse e ka regjistruar pronën e saj në vitin 2008.

8. Veç sa më lart, gjykata e shkallës së parë ka argumentuar se, referuar VKM-së nr. 138, datë 14.10.2009, provohet se sipërfaqja ndërtimore e vetëdeklaruar për legalizim prej të paditurit Alfred Ndeca, ka kaluar në pronësi të këtij të fundit.

## II. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit.

9. Gjykata e Apelit Tiranë vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi, në kuptim të nenit 466/ "a" të Kodit të Procedurës Civile. Ky vendim i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe prapësimeve të lëve ndërgjyqëse, që përbëjnë objektin e mosmarrëveshjes.

10. Kështu rezulton që paditësit kanë ngritur padinë e rivendikimit, e cila është padia pronarit posedues ndaj poseduesit të paligjshëm jopronar. Vetëdeklarimi për legalizim i një ndërtimi informal është thjesht dhe vetëm një premisë për vendimin e legalizimit të tij në të dhmen, pas shqyrtimit të plotësisht ose jo të kushteve ligjore prej autoritetit kompetent të ministratës publike, por nuk i shndërron automatikisht të paditurit, nga posedues të paligjshëm, posedues të ligjshëm. Mundet që ky ndërtim, në përfundim të procesit administrativ, të çeltojë se nuk plotëson kushtet ligjore për legalizim dhe, si i tillë, të mos legalizohet.

11. Në rast të kundërt, vetëm nëse ndërtimi ligjërohet, duke kaluar në pronësi të paditurve, nëpërmjet procesit të legalizimit, atëherë ata shndërrohen në posedues të ligjshëm të për shkak të kësaj cilësie të re, pronësi që fitohet sipas një mënyrë të përcaktuar në një ligj të saçëm, i cili parashikon humbjen, për shkak fitimi të një personi tjetër, të së drejtës së pronësisë që i përket pronarit të mëparshëm, në kuptim të nenit 191 të Kodit Civil.

12. Duke u kthyer tek rasti për gjykim, ndryshe nga sa ka pretenduar pala paditëse në kërkesën e saj, gjykata e apelit çmon se, me vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka rrëzuar padinë, nuk i është mohuar e drejta për akses në gjykatë, që përbën element të procesit të rregullt gjyqësor, parashikuar nga neni 6 i KEDNj-së e 42 i Kushtetutës, si dhe as i është cënuar e drejta e tij pronësisë, në shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së dhe 41 të Kushtetutës.

13. Edhe pse të paditurit nuk ishin pronarë me titull të rregullt pronësie mbi truallin i objektit rivendikimi, ky i fundit nuk ekziston më në gjendjen e tij fillestare, pra, si truall i lirë, ke qenë se mbi një pjesë të tij të paditurit kanë ndërtuar banesa ku jetojnë, për të cilat gëzojnë drejtën e legalizimit, realizimi i së cilës ka rezultuar e provuar se është finalizuar për të daturin Alfred Ndreca dhe është në përfundim për të paditurin Sefer Mena, fqinj me të parin, a tregon se ekziston një pritshmëri legjitime për legalizim edhe për këtë të fundit.

14. Posedimi si pushtet faktik apo sundim efektiv mbi sendin dhe si tagër i së drejtës pronësisë mund të qëndrojë si e drejtë subjektive edhe në mënyrë të mëvetësishme, të pavarur nga tagrat e tjera. Nëpërmjet posedimit për një kohë të caktuar mund të lindë e drejta për t'u onësuar nëpërmjet një procesi administrativ, siç është ai i legalizimit, apo nëpërmjet raskrimit fitues etj, siç parashikohet në Kodin Civil.

15. Në çështjen Oneryildiz kundër Turqisë, GjEDNJ-ja u shpreh se "...ndërtimi i rrakës dhe fakti që kërkuesi kishte jetuar në të së bashku me familjen përfaqësonte një interes elbësor material, i cili, duke qenë se ishte toleruar nga autoritetet, arrinte të përbënte një asuri për qëllimet e nenit 1§1 të Protokollit 1 të Konventës.....".

16. Po kështu, në Vendimin nr. 10508/02, për çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, GjEDNJ-ja është shprehur se: "88. Gjykata rikujton, referuar jurisprudencës së saj, se "prona" pas kuptimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 mund të jenë "prona ekzistuese" ose asete, përfshirë këtu pretendime, mbi të cilat aplikanti mund të argumentojë se ai ose ajo ka së paku një pritshmëri legjitime" për të përfutur gëzim paqësor të së drejtës së tij mbi pronën".....90..... "në rastet kur interesi i pronësisë është në natyrën e një pretendimi, mund të konsiderohet si një "aset" vetëm nëse ka një bazë të mjaftueshme në ligjin vendas, për shembull kur është krijuar një praktikë në gjykatat vendase, të cilat e konfirmojnë atë....".

17. Gjithashtu ky qëndrim konfirmohet edhe në Vendimin mbi ankimin nr. 7352/03, për çështjen Beshiri kundër Shqipërisë, ku thuhet: "78....Pasuritë mund të jenë "pasuri ekzistuese" ose asete, përfshirë pretendime në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një "pritshmëri të ligjshme" për të fituar gëzim efektiv të një të drejte për pronën. Duke bërë krahasime, shpresa për njohjen e një të drejte pronësie, e cila ka qenë e pamundur të ushtrohej efektivisht, nuk mund të konsiderohet si "pasuri" brenda kuptimit të nenit të protokollit nr. 1.....". GjEDNJ-ja e ka konsoliduar këtë qëndrim edhe në vendimet mbi çështjet Ramadhi kundër Shqipërisë, Driza kundër Shqipërisë, Vrioni etj kundër Shqipërisë.

18. Bazuar në arsyetimin si më sipër, ashtu siç ka konkluduar edhe gjykata e shkallës së parë, arrihet në përfundimin se të paditurit kanë një interes thelbësor për të mbrojtur, pikërisht pronësinë mbi pasuritë-banesat e ndërtuara mbi truallin objekt material gjykimi, të fituar apo pritur për të fituar nëpërmjet legalizimit. Kjo sa kohë është provuar vlerësimi prej autoriteteve kompetente se ndërtimi i të paditurve plotëson kushtet dhe kriteret ligjore për legalizim dhe nuk është nga ata që përjashtohet nga proces, duke shkaktuar që të paditurit mund të jenë përfitues.

19. Sa i takon pretendimit tjetër të parashtruar në ankim nga pala e paditur, sipas të cilës gjykata ka gabuar që ka rrëzuar padinë, sa kohë nuk është provuar të ketë dalë ndonjë vendim i Këshillit të Ministrave për shpronësimin e pasurisë së paditësit dhe dhënien e saj në



ronësi palës së paditur, gjykata e apelit e gjen atë të pabazuar. Kështu është provuar se të aditurit Alfred dhe Lulëzime Ndreca kanë përfituar të drejtën që, kundrejt pagesës, t'u kalojë në ronësi toka objekt rivendikimi, ndërsa i padituri Sefer Mena, duke qenë sqinj me të parët, ka rezultuar se është edhe ai drejt finalizimit të procesit.

20. Lidhur me daljen ose jo të një VKM-je për shpronësimin e pasurisë së palës aditëse, ky fakt nuk ka ndikim në zgjidhjen e rastit për gjykim, pasi përbën një marrëdhënie rridike ndërmjet kësaj pale dhe shtetit, ndërsa fati i ndërtimeve të të paditurve nuk mund të dhjet në mënyrë kushtëzuese me këtë proces.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenin 466/ "a" të Kodit të Procedurës Civile,

### VENDOSI

-Lënien në fuqi të Vendimit nr. 4316, datë 26.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

-Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve nga e esërmja e shpalljes.

-U shpall në Tiranë, sot, me datë 02.03.2017

**GJYQTAR**  
**ARTUR KALAJA**

**GJYQTARE**  
**MARIA QIRJAZI**

**GJYQTAR**  
**ERVIN METALLA**

**GJYKATA E APELIT**  
**TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**  
**VËRTETOHET**  
**NJËSIA ME ORIGINALEN**



*K. Selimovic*  
*Quelina Kopellut*

**MAGJISTRATË TË DIPLOMUAR NË VITIN 2001 NE SHKOLLEN E  
MAGJISTRATURES**

| Nr | Emër Atësi Mbiemër       |
|----|--------------------------|
|    | <b>GJYQTAR</b>           |
| 1  | Amarildo Ahmet Laci      |
| 2  | Gurali Mitat Brahimllari |
| 3  | Dritan Esat Caka         |
| 4  | Alma Filat Arapi         |
| 5  | Artur Sadik Kalaja       |
| 6  | Rasim Hysen Doda         |
| 7  | Klodiana Begator Gjyzari |
| 8  | Rilinda Qemal Bajrami    |
| 9  | Ervin Nazmi Metalla      |
| 10 | Edlira Fuat Bulaj        |
| 11 | Klodian Qemal Kurushi    |
| 12 | Blerona Fadil Hasa       |
| 13 | Iliriana Cerciz Olldashi |
| 14 | Albana Burhan Boksi      |
| 15 | Saida Lumner Dollani     |
| 16 | Qemal Petrit Zaimi       |
| 17 | Arta Kosta Llazari       |
| 18 | Valbona Luigj Vata       |
| 19 | Tereza Preg Zefi         |
|    | <b>PROKUROR</b>          |
| 20 | Ardian Enver Braho       |